**FINANCAT PUBLIKE**

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Departamenti I Shkencave Politike** |
| **Titulli i lëndës:** | **FINANCAT PUBLIKE** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Zgjedhore** |
| **Viti i studimeve:** | **Pestë (I-të)** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+1** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **5** |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Dr. Sejdi Rexhepi** |
| **Detajet kontaktuese:** | **sejdi.rexhepi@uni-pr.edu 045/ 308 809** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Financat publike janë degë e ekonomisë e cila merret me studimin e roli të shtetit në ekonomi, mënyrën se si ai i siguron dhe përdor te hyrat për ushtrimin e funksionit të tij, ofrimin e të mirave publike dhe sigurimin e mirëqenies së përgjithshme shoqërore.<br>Financat publike studiojnë mënyrën se si shteti i siguron fondet për kryerjen e aktivitetit të tij, si dhe qëllimin, produktivitetin dhe efikasitetin e përdorimit të tyre.<br>Përmes lëndës financat publike do të mësojmë rolin e shtetit në alokimin e resurseve, shpërndarjen e të ardhurave dhe në stabilizimin e ekonomisë.<br>Në këtë lëndë do të mësojmë për rolin e tregut në ekonomi, arsyet e ndërhyrjes së shtetit dhe shkallën e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Do të mësojmë për taksat dhe shpenzimet shtetërore, t'mirat publike dhe private, eksternalitetet, dështimet e tregut por edhe për dështimet e shtetit duke interpretuar shpjegimet e ekonomistëve përgjatë historisë sikurse edhe të atyre bashkëkohore. |
| **Qëllimet e lëndës:** | 1. Që studentëve të ju ofrohen njohuri hyrëse për konceptet themelore të Financave Publike.<br>2. Që studentëve të ju ofrohen njohuri të mjaftueshme për të kuptuar rolin e Financave Publike në jetën ekonomike dhe shoqërore të shteteve bashkëkohore dhe gjatë historisë. |

| | |
|---|---|
| | 3. Që studentët të ju ofrohet njohuri të mjaftueshme për rolin e shtetit në ekonominë bashkëkohore si dhe lidhur me rolin e shtetit në sigurimin e të mirave publike.<br>4. Që studentët të kuptojnë se si sistemet tatimore duhet të jenë të formuluara, në mënyrë që të mund të nxitet efikasiteti ekonomik dhe në të njëjtën kohë të jenë të harmonizuara me parimet themelore të drejtësisë.<br>5. Që studentët të kuptojnë elementet bazë të politikës së shpenzimeve buxhetore, kategoritë themelore të buxhetit si dhe të kuptojnë arsyet se pse shteti shpesh është joefikase.<br>6. Që studentët të kuptojnë rolin e financave publike në kuadër të Politikave të Përgjithshme Ekonomike. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:<br><br>1. Të kuptojnë se çka janë financave publike, cilat janë funksionet kryesore të Financave Publike dhe cili është roli dhe vendi i politikës fiskale dhe buxhetit publik në kuadër të financave publike.<br>2. Ti njohin dhe të kuptojnë llojet e të mirave publike, dhëniet shtetërore dhe private për të mira publike, si dhe të kuptojnë rolin e tregut dhe të shtetit në sigurimin e të mirave publike si dhe në shpërndarjen e të ardhurave të krijuara.<br>3. Të identifikoj llojet kryesore të dhënieve publike, shkaqet e rritjes së të dalave publike në shtetin bashkëkohorë, si dhe të kuptojnë metodat kryesore për vlerësimin e të dalave publike.<br>4. Të identifikojnë llojet kryesore të tatimeve si dhe parimet kryesore të mbledhjes së tatimeve si dhe të njohin burimet e tjera të t' hyrave publike siç është borxhi publik, llojet e borxheve publike, problemet kryesore të borxhit publik, si dhe kufijtë e borxhit publik. |

| | |
|---|---|
| | 5. Të kenë aftësi të mjaftueshme për të kuptuar rolin e shtetit në ekonomi si dhe pikëpamjet e ndryshme lidhur me rolin e shtetit dhe të tregut në sigurimin e mirëqenies së përgjithshme shoqërore.<br>6. Që aftësitë dhe dituritë e fituara të mund ti përdorin në mënyrë kreative për të njohur, kuptuar, krahasuar, analizuar dhe për të zhvilluar mendimin profesional dhe kritik lidhur me efikasitetin e ekonomisë së tregut dhe rolin e shtetit në rishpërndarjen e të ardhurave.<br>7. Të kenë aftësi dhe dije të mjaftueshme për të hartuar dhe zhvilluar mendime dhe koncepte personal lidhur me politikat fiskale dhe buxhetin publik të Kosovës,  kategoritë kryesore të t' hyrave dhe të dalave të buxhetit të Kosovës, si dhe të jenë në gjendje që të interpretojnë, krahasojnë dhe të nxjerrin përfundime lidhur me politikat fiskale. |

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 13 | 26 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime  në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 5 | 5 |
| Detyra të  shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezantimet, etj. | | | |
| **Totali** | | | 125 |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | ***a).Qasja është e bazuar në pjesëmarrjen aktive të studentëve***<br><br>1. Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimit studentëve përmes ligjëratave,<br>2. Përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore<br>3. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret<br>4. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.<br><br>**b). Aktivitetet Grupore**<br>1. Tryeza pune, diskutime grupore, prezantime grupore<br><br>**c). Aktivitetet tjera**<br>1. Kërkime të pavarura nga studentët<br>2. Prezantimi i rezultateve<br>3. Seminare<br><br>**d). Mjetet e punës:**<br>Tekste mësimore, artikuj, harta, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimdhënësi, etj. |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të disa kritereve bazë. Studentët do të kenë dy teste provuese me shkrim gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe një test (provimin) përfundimtar. Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marr parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin final si dhe angazhimin e përgjithshëm.<br>Çdo student ka për obligim që të përgatisë një punim seminarik i cili është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm nga kjo lëndë. Tema e seminarit duhet të caktohet në bashkëpunim me mësimdhënësin e në pajtim me planin mësimorë nga lënda.<br><br>Nota do të ndërtohet duke marrë për bazë këto kritere:<br>Vlerësimi i parë: 20%<br>Vlerësimi i dytë: 20% |

| | |
|---|---|
| | Detyrat e shtëpisë 10%<br>Angazhimi dhe vijimi 10%<br>Provimi final 40%<br>**Total 100%** |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | a). Në gjuhen shqipe:<br><br>1. Ligjëratat e mësimdhënësit<br>2. Harvey S. Rosen, Financa publike, përkthim në shqip nga Manjola Kalica/ Gentiana Cane, botues UET Press & MAPO Edition, Tiranë, 2010. |
| **Literatura shtesë:** | b). Në anglisht<br><br>**1. Public Finance and Public Policy,** Jonathan Gruber, 7th edition, Macmillan Learning**, 2022**<br><br>1. Harvey Rosen, Ted Gayer, Public Finance, 10th Edition, The McGraw-Hill, 2013.<br>2. Joseph E. Stiglitz, Jay K. Rosengard, Economics of the Public Sector (Fourth Editio), W.W. Norton Company. Inc., 2015.<br>3. Public finance in theory and practice / Richard A. Musgrave, Peggy B. Musgrave, New York; McGraw-Hill Book Company, 1989. |

| **Plani i dizejnuar i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjërata që do të zhvillohet** |
| ***Java e parë:*** | **Njoftime hyrëse;**<br>Njoftimi me student, prezantimi i mësimdhënësit, prezantime hyrëse lidhur me lëndën dhe programin mësimor, njoftimi lidhur me metodologjinë e punës, vlerësimit dhe notimit. Prezantimi hyrë lidhur me Politikën Fiskale dhe Buxhetin Publik. |
| ***Java e dytë:*** | ***Financat Publike dhe rëndësia e tyre;*** |

| | |
|---|---|
| | Kuptimi dhe përmbajtja e Financave Publike, Funksionet kryesore të Financave Publike, Financat Publike dhe raporti i tyre ndaj shtetit, Metodat e kërkimit të Financave Publike. |
| ***Java e tretë*:** | ***Efikasitet i Tregut;***<br>Çka kuptojmë me ekonomi efikase, Ekonomia e mirëqenies dhe efikasiteti Pareto, Efikasiteti Pareto dhe Individualizmi, Premisat baze të ekonomisë së mirëqenies, |
| ***Java e katërt:*** | **Të Mirat Publike, Alokimi, Distribuimi dhe Zgjedhja Publike;**<br>Plotësimi i nevojave për të mira publike, Llojet e të Mirave Publike, Dhëniet Publike, Shpërndarja e të ardhurave, Zgjedhja Publike. |
| ***Java e pestë:*** | ***Vendosja e Baraspeshës në mes të Sektorit Publik dhe atij Privat;***<br>Çka është shteti, Mënyra e të menduarit të ekspertëve të ekonomisë për sektorin publik, Analiza e sektorit publik, Modelet makroekonomike, Ekonomia normative dhe pozitive, Tri funksione e Mazgrevit, Mospajtimet midis ekonomistëve. |
| ***Java e gjashtë*:** | **Vlerësimi i pare** |
| ***Java e shtatë:*** | **Të hyrat Publike;**<br>Kuptimi dhe llojet e tatimeve, Parimet e tatimit, Barazia në tatimit, Barra tatimore, Burimet e tjera të t' hyrave publike. |
| ***Java e tetë:*** | ***Të Dalat Publike;***<br>Kuptimi dhe llojet e të dalave publike, Dinamika e rritjes së të dalave publike, Shkaqet e rritjes së të dalave publike, Vlerësimi i të dalave publike, Metodat analitike për vlerësimin e efikasitetit të konsumit publik, (Cost-benefit analiza, Cost effectivenss analiza) |
| ***Java e nëntë:*** | ***Tatimi dhe efikasiteti ekonomik;***<br>Të tatuarit dhe efikasiteti ekonomik, Efektet e tatimit të cilat i bartin konsumatorët, Efektet e tatimit të cilat i bartin prodhuesit, Tatimi optimal, Të tatuarit optimal dhe efikasiteti-Pareto. |
| ***Java e dhjetë:*** | ***Sektori Publik në Ekonomin e Përzier;***<br>Roli i shtetit në ekonomi, Pikëpamjet e ndryshme lidhur me rolin e shtetit, Jo përfektshmeria e tregut, Jo efikasitet i shtetit. |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | **Vlerësimi i dytë** |

| | |
|---|---|
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | ***Borxhi Publik;***<br>Kuptimi dhe roli i borxhit publik, Llojet e borxheve publike, Problemet kryesore të borxhit publik, Qeverisja me borxhin publik, Kufijtë e borxhit publik. |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | ***Politika fiskale në Kosovë;***<br>Tatimi në të ardhura personale, Tatimi në vlerën e shtuar, Tatimi në fitim të korporatave, Tatimi i paragjykuar, Akciza, Tatimi në pronë, Të hyrat e tjera. |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | ***Buxheti Publik;***<br>Buxheti, Cikli Buxhetor, Planifikimi Buxhetor, Pjesëmarrësit në Procesin Buxhetor, Ekzekutimi i Buxhetit, Tiparet kryesor të Buxhetit Publik të Kosovës, Të hyrat dhe të dalat e buxhetit të Kosovës, Ligji Buxhetor. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | **Vlerësimi përfundimtar** |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Studentët me qëllim të arritjes së suksesit të lartë në studime duhet që:<br>1. Të vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet e parapara<br>2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjërata përmes pyetjeve, debateve dhe formave tjera të veprimit interaktiv<br>3. Në marrëveshje me mësimdhënësin të punojnë një punim seminarik (detyrë shtëpie) prej 10-12 faqe<br>4. Të marrin pjesë në testet e ndërmjetme si dhe në testin përfundimtar<br>Gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, testeve apo provimeve kanë për obligim që t'i nënshtrohen kodit të mirësjelljes (mbajtja e qetësisë në mësim, hyrja me kohë në sallë, lëshimi i sallës me pëlqimin e mësimdhënësit, etj). |